

Shqipëria në edicionin e 58-të të Ekspozitës Ndërkombëtare të Artit, Venecia 2019

Driant Zeneli

Maybe the cosmos is not so extraordinary

11 Maj –24 Nëntor 2019

Hapja: 10 Maj, 2:30pm

Komisioner: Ministria e Kulturës së Republikës së Shqipërisë

Pavijoni Shqiptar në Arsenale Artiglierie

30122 Venice

Italy

Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë ka kënaqësinë të njoftojë për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në edicionin e 58-të të Ekspozitës Ndërkombëtare të Artit, Venecia 2019, me *Maybe the cosmos is not so extraordinary*, një projekt i artistit Driant Zeneli, kuruar nga Alicia Knock.

Si i shtyjme kufijtë tanë fizikë dhe mendorë pa u bërë superheronj? A mund të bashkëjetojnë e mundura/realja dhe imagjinaria ? Në thelbin e hulumtimit të Driant Zenelit është ripërkufizimi i dështimit, utopisë dhe ëndrrës. Nëpërmjet rrëfimit dhe performancës filmike, Driant Zeneli sfidon fiksimin e njerëzve me kufijtë e vetë atyre, duke nxjerrë në dritë përgjigjet alternative ndaj brishtësisë së qenieve njerëzore dhe planetit Tokë. Ai sfidon marrëdhënien fizike dhe metafizike midis njeriut dhe hapësirës, materies dhe ëndrrës, gravitetit dhe kontrollit.

Maybe the cosmos is not so extraordinary (2019), është një video instalacion skulpturor i cili bazohet në një projekt multidisiplinar të titulluar *Beneath a surface there is just another surface*, i cili nisi në vitin 2015 në Metalurgjik, një kompleks industrial dystopian, në qytetin e Elbasanit në Shqipëri. Projekti dhe titulli i tij rrjedhin nga novela fanatistiko-shkencore *On the way to Epsilon Eridani* (1983) e shkruar nga fizikanti dhe shkrimtari shqiptar Arion Hysenbegas.

Instalacioni zhvillohet nga një film me dy kanale, ngjarjet e të cilit zhvillohen në minierat e Bulqizës, një qytet në verilindje të vendit, ku, që nga viti 1918, është nxjerrë minerali i kromit. Kromi përbën një burim kryesor për zhvillimin industrial të Shqipërisë dhe bie ndesh me konfliktet ekonomike dhe politike në Jugun Global (Botën në Zhvillim). Filmi paraqet një grup adoleshentësh nga Bulqiza të cilët zbulojnë një kapsulë kozmike e cila ndjek udhëtimin e kromit, nga nxjerrja dhe përpunimi i tij brenda fabrikës deri në eksportimin dhe shfrytëzimin e tij në mbarë botën. Prandaj, ky udhëtim hapësinor "gjeopolitik" e kthen këtë mjedis industrial të errët dhe dramatik në një hapësirë ambivalente për kolaps dhe fluturim.

Nëpërmjet rrëfimit binar, koreografisë së përpiktë të imazhit dhe zërit, fabrika funksionon jo vetëm si një hapësirë industriale apo qendër gjeopolitike, por edhe si një forcë vizualisht

performuese. Nxjerrja e kromit shndërrohet në një imazh skulpturor hipnotik dhe, si pasojë, e tërë fabrika përkthehet në një instalacion të madh "paralel" të dritës dhe zërit, i vulosur organikisht në muret e Arsenales. Në këtë hapësirë produktive dhe magjepsëse, Driant Zeneli synon të krijojë tension midis një realiteti shtypës nëntokësor dhe një hapësire utopike të mundësisë dhe çlirimit.

Maybe the cosmos is not so extraordinary përpiqet të zbulojë fizikisht aftësinë e të zakonshmes, madje edhe në qoshet e saj më të errëta, për të zgjeruar ekzistencën tonë.

Driant Zeneli (1983, Shkodër, Shqipëri) jeton dhe punon mes Tiranës dhe Milanos. Në vitin 2008 fitoi Çmimin Ndërkombëtar të Artit Bashkëkohor Onufri, në Tiranë, në vitin 2009 Çmimin e Artistëve të Rinj Europeanë *Trieste Contemporanea* dhe në vitin 2017 Çmimin *MOROSO*, Itali. Ai ka qenë drejtor artistik i *Mediterranea 18*, Bialja e Artistëve të Rinj nga Europa dhe Mesdheu, që u zhvillua për herë të parë në vitin 2017 midis Tiranës dhe Durrësit. Është bashkëthemelues i Platformës Bashkëkohore të Artit Harabel në Tiranë. Veprat e tij janë ekspozuar në: GAMeC, Muzeun e Artit Modern dhe Bashkëkohor, Bergamo, (2019); *Passerelle, Centre d'Art Contemporain*, Brest, (2018); Mostyn Gallery, Uells, Britani e Madhe (2017); MuCEM, Marsejë, (2016); Academie de France à Roma, (2016); *Centre Pompidou*, Paris (2016); *IV Bienal del Fin del Mundo*, Kili (2015); GAM, Muzeu i Artit Modern dhe Bashkëkohor në Torino (2013); *White House Biennial*, Athinë (2013); KCCC, Klaipeda, Lituani (2013); ZKM, Karlsruhe (2012); MUSAC, Castilla León, Spanjë (2012); Bialja e Pragës 5, Pragë (2011); *Trongate 103*, Glasgow (2011); Galeria Kombëtare e Kosovës, Prishtinë (2010); *Museo d'Arte Contemporanea Villa Croce, Genoa* (2009); Galeria Kombëtare e Tiranës, (2008).

Alicia Knock, kuratore në *Centre Pompidou* në Departamentin e Artit Bashkëkohor dhe Perspektiv të krijuar dhe drejtuar nga Christine Macel, punon për zgjerimin e muzeut në Afrikë dhe Europën Qendrore, nëpërmjet blerjeve dhe ekspozitave. Ajo eksploron formatet e reja të ekspozimit dhe të punës, duke e sfiduar vetë muzeun përmes projekteve multidisiplinare (Harmony Korine, 2017). Përgjegjëse për ekspozitat e *Duchamp Prize* (Kader Attia, Yto Barrada, Ulla von Brandenburg dhe Barthélémy Toguo, 2016, "*The most foreign country*", gratë artiste nga *Duchamp Prize*, Fondacioni Fernet Branca, 2017, Maja Bajevic, Joana Hadjithomas dhe Khalil Joreige, Charlotte Moth, Vittorio Santoro, 2017), ajo është e përfshirë edhe në hapësirën e re të projektit *Pompidou, Galerie 0*, me qëllim kthimin e tij në një laborator për praktika të reja (*Museum On / Off*, 2016).

Katalogu: Alicia Knock (ed.), Driant Zeneli. *Maybe the cosmos is not so extraordinary*, Botimet Mousse, 2019, në gjuhën angleze dhe shqipe. Me më shumë se njëzet e pesë kontribute nga artistë, shkencëtarë, shkrimtarë dhe kuratorë.

Kontakt

Claudia Buizza, asistent kuratore: [albanianpavilion2019 \[at\] gmail.com](mailto:albanianpavilion2019@gmail.com)

